STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 5 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO DHE DEPARTAMENTI I SHËNDETËSISË KËRKOJNË LEJEN FEDERALE PËR TË NDIHMUAR PËRSHPEJTIMIN E KUJDESIT DHE NDIHMËS PËR NJUJORKEZËT E DËMTUAR NGA URAGANI SANDY

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se Departamenti i Shëndetësisë i shtetit të Nju Jorkut ka paraqitur një kërkesë për leje sipas Seksionit 1135 nga Departamenti Amerikan i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore e cila po të plotësohet, do të ndihmojë punonjësit e shëndetësisë të Nju Jorkut në përpjekjet e tyre për të plotësuar nevojat imediate të të dëmtuarve nga uragani Sandy.

Leja do të zbuste disa rregulla administrative dhe të ruajtes së të dhënave, përfshi dokumentacionin, zhvendosjen e pacientëve dhe kërkesat për faturimin, me qëllim përshpejtimin e sigurimit të kujdesit shëndetësor për njujorkezët në nevojë pas uraganit Sandy.

"Miliona njujorkezë dhe mijëra pacientë në të gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor të shtetit u goditën nga shkatërrimet e shkaktuara nga uragani Sandy, dhe ne duhet të veprojmë me shpejtësi për të siguruar kujdes cilësor për të gjithë njerëzit në nevojë", tha guvernatori Cuomo. "Qeveria federale ka një partner shumë të fuqishëm gjatë gjithë procesit të rimëkëmbjes nga stuhia dhe kjo leje do të jetë një aset i madh në përpjekjet tona për të siguruar që shërbimet shëndetësore të jenë të gatshme ndërkohë që ne reagojmë ndaj uraganit Sandy".

Më 31 tetor 2012, sekretarja e HHS Kathleen Sebelius arriti në përfundimin se ekziston emergjenca e shëndetësisë publike dhe ajo ka ekzistuar qysh më 27 tetor 2012, në shtetin e Nju Jorkut. Leja sipas Seksionit 1135 do të lehtësonte disa rregulla administrative dhe kërkesat për mbajtjen e të dhënave, me qëllim që:

- Të lejohen shërbimet e faturimit dhe të kërkesave në rastet kur siguruesit e kujdesit shëndetësor nuk janë në gjendje të paraqesin dokumentacionin standard
- Të zbuten kërkesat për të lehtësuar më shumë zhvendosjen e pacientëve nga ndërtesat e dëmtuara dhe të pasigurta në mjedise më të sigurta
- Të pezullohen kërkesat që potencialisht kufizojnë shërbimet dhe pengojnë siguruesit të pranojnë pacientë të rinj
- Të lehtësohen aprovimet e përshpejtuara për shpërnguljen e operacioneve të siguruesve

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov

Dhoma Ekzekutive e shtetit të Nju Jorkut (New York State | Executive Chamber)
| press.office@exec.ny.gov| 518.474.8418

Albanian